

Neni 2

Në nenin 36, pas paragrafit 5 shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), si vijojnë:

"(6) Në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni personi është i detyruar që Drejtorisë për të hyra publike t'ia prezantojë dëshmitë për burimet e mjeteve nga të cilat është fituar prona dhe mjetet me të cilat disponon personi dhe anëtarët e familjes së tij.

(7) Organet shtetërore, organet e njësive të vetadministrimit lokal, bartësit e qarkullimit të pagesave dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë, me kërkesën e Drejtorisë për të hyra publike dhe në afat të cilin ajo do ta caktojë, janë të detyruar t'i japin të gjitha informatat e nevojshme për konfirmimin e gjendjes faktike të cilat janë qenësore për hulumtimin e pronës dhe të gjendjes pronësore."

Neni 3

Në nenin 36-a paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Nëse në procedurën për hulumtimin e pronës dhe të gjendjes pronësore nuk dëshmohej se prona është fituar ose zmadhuar si rezultat i të ardhurave të cilat janë paraqitur dhe tatuuar, Drejtoria për të hyra publike do të marrë vendim për të tatuuarit me tatim personal. Bazë për llogaritjen e tatimit paraqet dallimi mes vlerës së pronës në kohën e fitimit dhe lartësia e dëshmuar e mjeteve për fitimin e saj. Tatimi i të hyrave të paraqitura përlllogaritët në shkallë prej 70%."

Pas paragrafit (1) shtohen tre paragrafë të rinj (2), (3) dhe (4) si vijojnë:

"(2) Në shumën e tatimit të përlllogaritët (e të papaguar) përlllogaritët dhe arkëtohet kamata në pajtim me Ligjin për procedurë tatimore, të llogaritët nga dita e marrjes së vendimit për tatim.

(3) Kundër vendimit mund të parashtrohet mjet juridik në pajtim me Ligjin për procedurë tatimore dhe i njëjti nuk e shtyn arkëtimin e tatimit.

(4) Arkëtimi i tatimit sipas vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (5).

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (6) numri "(2)" zëvendësohet me numrin "(5)".

Neni 4

Në nenin 36-b paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 shlyhen.

Neni 5

Titulli i Kreut VII ndryshohet si vijon: "Dispozita ndëshkimore dhe për kundërvajtje".

Neni 6

Në Kreun VII pas nenit 59 shtohet neni i ri 59-a si vijon:

"Neni 59-a

(1) Ai që me kërkesën e Drejtorisë për të hyra publike në afatin e caktuar nuk i dorëzon informatat e kërkuara për konfirmimin e gjendjes faktike për tatim do të ndëshkohet me dënim me burg prej tre muaj deri në një vit.

(2) Nëse veprën nga paragrafi (1) i këtij neni e bën personi zyrtar në organet shtetërore, organet e njësive të vetadministrimit lokal, bartësit e qarkullimit të pagesave, ose personi përgjegjës te personi juridik i cili kryen punë me interes publik dhe personat tjerë publikë do të ndëshkohet me dënim me burg prej një deri në tri vjet."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

113.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЦАРИНСКАТА ТАРИФА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за Царинската тарифа, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 16 јануари 2008 година.

Бр. 07-276/1
16 јануари 2008 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Бранко Црвенковски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Љубиша Георгиевски, с.р.

ЗАКОН
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА
ЗАКОНОТ ЗА ЦАРИНСКАТА ТАРИФА

Член 1

Во Законот за Царинската тарифа („Службен весник на Република Македонија" број 23/2003 и 69/2004), во Царинската тарифа која е составен дел на овој закон, ОДДЕЛ V, Глава 27, тарифен број 2710, тарифен подброј 2710 19 --Друго, по тарифниот став со тарифната ознака "2710 19 35 00" по расчленувањето "----За други намени:" тарифниот став со тарифната ознака 2710 19 41 00 -----Со содржина на сулфур што не надминува 0,05% по маса...20...кг "се заменува со три тарифни става со тарифни ознаки, наименување, царинска стапка и единечна мерка, кои гласат:

2710 19 41 10	-----Со содржина на сулфур што не надминува 0,05% по маса:	сл	кг
2710 19 41 30	-----Со содржина на сулфур што не надминува 0,001% по маса.....	20	кг
2710 19 41 90	-----Со содржина на сулфур што надминува 0,001% по маса, но не надминува 0,005% по маса.....	20	кг
	----- Друго.....		

Член 2

Во ОДДЕЛОТ VII Глава 39, тарифен број 3926, тарифен подброј 3926 90 --Друго, во тарифниот став со тарифна ознака "3926 90 99 10 - - - - Калапи за обулки" во колоната за царинската стапка бројот "5" се заменува со зборот "слично".

Член 3

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија".

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË
LIGJIT PËR TARIFËN DOGANORE

Neni 1

Në Ligjin për Tarifën doganore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/2003 dhe 69/2004), në Tarifën doganore e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji, në SEKSIONIN V, Kreu 27, në numrin tarifor 2710, nënnumrin tarifor 2710 19 --Tjetër, pas paragrafit tarifor me shenjën tarifore "2710 19 35 00", pas ndarjes "---- Për dedikime të tjera: "paragrafi tarifor me shenjën tarifore 2710 19 41 00 ----- Me përmbajtje sulfuri që nuk tejkalon 0,05% për peshë...20.kg" zëvendësohet me tre paragrafë tariforë me shenja tarifore, emërtime, shkallë doganore dhe masës për njësi, si vijojnë: